

PKUAR 2019

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 7003 REP.
NR. 2295 KOL.



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, ne Tirane, me 22.07. 2019, përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës se Noterisë Tiranë, Rr. "Pjetër Bogdani", nr. 13, lidhet kjo Kontrate nga dhe ndërmjet:

SHITËSI: **Z. Rudolf Dalipi**, shtetas shqiptar, lindur më 29.06.1972 në Ersekë, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. BI4138119 dhe nr. personal H20629040Q, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi")

dhe

BLERËSI: **Znj. Manuela Hoxha**, shtetase shqiptare, lindur më 13.11.1973 në Tiranë, banuese në adresën: Rr. "Jeronim De Rada" nr. 63/3, Tirane, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 025491289 dhe nr. personal H36113080H, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
Z. Ilirjan Hoxha, shtetas shqiptar, lindur më 20.06.1969, në Fier, banues në Tiranë, mbajtes i kartës së identitetit me nr. 024610110 dhe nr. personal G90620083G, madhor e me zotësi të plotë e juridike për të vepruar
Z. Torpe Mazniku, shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1963, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtes i kartës së identitetit me nr. 033995151 dhe nr. personal G30805120J, madhor e me zotësi të plotë e juridike për të vepruar;
(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar bashkarisht si "Blerësit" dhe secilit prej tyre si "Blerësi")

Palët e mësipërme në vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do të referohen individualisht si "Palë/a" dhe së bashku si "Palë/ët".

MEQËNËSE:

- A.** Shitësi është ortak dhe zotërues i 30% (tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "TOLIMO" Sh.P.K. (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS J81623004A, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.8, Rruga "Zenel Bastari", ndertesa nr.33, hyrja nr.1, Magazina.1, kodi postar.1017, kapitali themeltar i regjistruar i të cilës është në shumën 78.000.000 (shtatëdhjetë e tetë milionë) Lekë, sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (kopje e Ekstraktit nga Regjistri Tregtar i bashkëlidhet kësaj Kontrate ne formën e ANEKSIT A, i cili përbën pjese integrale të kësaj Kontrate);
- B.** Shitësi dëshiron t'u shesi Blerësve gjithsej 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë (në

vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “*Kuota*”), konkretisht Shitësi Rudolf Dalipi i shet 10% të kapitalit Blerëses Manuela Hoxha, 10% të kapitalit Blerësit Ilirjan Hoxha dhe dhe 10% të kapitalit Blerësit Torpe Mazniku.

C. Blerësit dëshirojnë të blejnë pjesëmarrjet sipas përcaktimeve të pikës B) më sipër.

PËR SA MË SIPËR, Palët ranë dakord për të lidhur këtë Kontratë Shitje Kuote.

NENI 1 - OBJEKTI

1.1. Nëpërmjet kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit dhe Blerësi fiton nga Shitësi pronësinë mbi pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërise dhe konkretisht:

- Shitësi Rudolf Dalipi i shet Blerëses Manuela Hoxha dhe Blerësja Manuela Hoxha blen nga Shitësi 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërise; dhe
- Shitësi Rudolf Dalipi i shet Blerësit Ilirjan Hoxha dhe Blerësi Ilirjan Hoxha blen nga Shitësi 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- Shitësi Rudolf Dalipi i shet Blerësit Torpe Mazniku dhe Blerësi Torpe Mazniku blen nga Shitësi 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

kundrejt dhe pas pagimit të çmimit të shitjes sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

NENI 2 - ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1. Çmimi i përgjithshëm i shitjes se Kuotës është 23.400.000 (njëzetë e tre milionë e katërqindmijë) Lekë dhe përbëhet nga çmimi i shitjes së pjesëve të kapitalit të transferuara si vijon:

- Çmimi i shitjes së 10% të kapitalit që Shitësi i transferon Blerëses Manuela Hoxha, në vlerën prej 7.800.000 (shtatë milionë e tetëqindë mijë) lekë; dhe
- Çmimi i shitjes së 10% të kapitalit që Shitësi i transferon Blerësit Ilirjan Hoxha, në vlerën prej 7.800.000 (shtatë milionë e tetëqindë mijë) lekë; dhe
- Çmimi i shitjes se 10% të kapitalit që Shitësi i transferon Blerësit Torpe Mazniku, në vlerën prej 7.800.000 (shtatë milionë e tetëqindë mijë) lekë.

Palët deklarojnë dhe garantojnë se çmimi i shitjes është caktuar në marrëveshje ndërmjet tyre dhe se ai gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm.

2.2. Çmimi i shitjes i përcaktuar në pikën 2.1. më sipër është bruto dhe Shitësi deklaron e garanton Blerësit se marrin përsipër të gjithë detyrimet për llogaritjen, deklarimin dhe pagimin e tatimit në burim nga të ardhurat nga kalimi i pronësisë së pjesëve të kapitalit sipas kësaj Kontrate, duke i përjashtuar Blerësit nga çdo përgjegjësi dhe detyrim në lidhje me sa më sipër dhe duke garantuar se asnjë përgjegjësi e asnjë lloji nuk do të lindë për Blerësit dhe se çdo përgjegjësi e çdo lloji dhe në raport me çdo palë të tretë, për shkak të apo në lidhje me përmbushjen apo mospërmbushjen e detyrimeve për llogaritjen, deklarimin, mbajtjen dhe pagimin e tatimit të zbatueshëm, do të merret përsipër tërësisht dhe pa asnjë rezervë nga Shitësi.

2.3. Çmimi i përgjithshëm i shitjes se Kuotës do të depozitohet me lidhjen e kësaj Kontrate nga Blerësi dhe sipas raporteve të caktuara në nenin 2.1. më sipër në llogarinë bankare të Shitësit pranë Bankës

“Credins” me nr. 00000165813, brenda 15 (pesëmbëdhjete) diteve pune nga nënshkrimi i kësaj kontrate. Vërtetimi/et / dokumenti/et bankare që vërtetojnë depozitimin e shumës së çmimit të shitjes në vlerën e përgjithshme prej 23.400.000 (njëzetë e tre milionë e katërqindë mijë) lekë do t'i bashkelidhet kësaj Kontrate, do të bëhet pjesë e pandashme e saj dhe do të provojë tërësisht pagimin. Menjëherë me depozitimin e shumës së mësipërme në llogarinë bankare të Shitësit, Palët do depozitojnë për regjistrim këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3 - KALIMI I PRONËSISË

- 3.1.** Pronësia mbi pjesët e kapitalit që transferohen sipas kësaj Kontrate kalon nga Shitësi te Blerësi me lidhjen e kësaj Kontrate dhe depozitimin e çmimit të përgjithshëm të shitjes në llogarinë bankare të Shitësit, sipas përcaktimeve të nenit 2 më sipër. Menjëherë me depozitimin e çmimit të shitjes në llogarinë bankare të Shitësit, kjo Kontratë do të regjistrohet në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas përcaktimeve të nenit 2 më sipër.
- 3.2.** Palët konfirmojnë që kalimi i pronësisë mbi Kuotën do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit bazuar në këtë Kontratë dhe në dokumentet vërtetuese (mandatet bankare) që provojnë depozitimin e çmimit të përgjithshëm të shitjes së Kuotës në llogarinë bankare të Shitësit.
- 3.3.** Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, pas kompletimit të kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:
- Z. Torpe Mazniku bëhet zotërues i 1 (një) kuote me vlerë prej 39.000.000 (tridhjetë e nëntë milionë) lekë, që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Znj. Manuela Hoxha mbetet zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë prej 23.400.000 (njëzetë e tre milionë e katërqindë mijë) lekë, që përfaqëson 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - Znj. Ilirjan Hoxha bëhet zotërues i 1 (një) kuote me vlerë prej 15.600.000 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqindë mijë) lekë, që përfaqëson 20% (njëzet përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

NENI 4 - DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1.** Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
- a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
 - b. Shoqëria është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar, e regjistruar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar.
 - c. Shoqëria nuk është në proces likuidimi apo falimentimi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë kërkesë për likuidim/faliment dhe në bazë të rezultateve të saj nuk parashikohet të cenohet ekzistenca e saj nga asnjë procedurë likuidimi / falimenti / administrimi të detyrueshëm etj.
 - d. Aktivitetet e zotëruara nga Shoqëria janë në pronësinë e saj të plote dhe ligjore dhe titujt e pronësisë dhe të drejtat reale të Shoqërisë nuk cenohen nga asnjë pretendim i asnjë pale të

trete dhe Shoqëria nuk ka detyrime ndaj te tretëve veç atyre qe pasqyrohen ne librat dhe regjistrimet kontabël te Shoqërisë.

- e. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- f. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të eviksionit dhe garanton se në rast se ndonjë palë e tretë do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejta mbi Kuotën, Shitësi do të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën të mos cenohet në asnjë mënyrë a masë.
- g. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejte parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën. Shitësi ka të drejte të shesë dhe t'ia transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- h. Shitësi garanton se Shoqëria nuk ka detyrime ndaj të tretëve veç atyre që rezultojnë nga dokumentacioni aktual kontabël që i është vendosur në dispozicion Blerësit dhe çdo pretendim nga të tretët për detyrime të pa përmbushura financiare, detyrime të çfarëdolloji të Shoqërisë, përfshirë edhe detyrime tatimore, gjoba, detyrime ndaj shtetit apo të tretëve në përgjithësi dhe pa kufizim nga dita e regjistrimit të Shoqërisë e në vijim.
- i. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- j. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i sigurojë atij kontrollin efektiv të Shoqërisë në përputhje me të drejtat që rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.
- k. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra të plota për të blerë pjesëmarrjet në kapitalin e Shoqërisë sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- b. Blerësi do të paguajë rregullisht çmimin e shitjes sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- c. Blerësi është njohur, ka dijeni dhe pranon dokumentacionin e themelimit dhe regjistrimit të Shoqërisë që Shitësi i ka vendosur në dispozicion përpara lidhjes së kësaj Kontrate.
- d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- e. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

NENI 5 - DISPOZITA TË FUNDIT

5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.3. Kjo Kontratë përmban marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me goje apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

Kontratë Shitje Kuote

Faqja 4 nga 5

5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen:

- *Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë*
- *Vendimi i Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotës*
- *Ekstrakt nga Regjistri i Barrëve Siguruese*
- *Kopje të dokumenteve të identifikimit të Palëve.*

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër origjinale e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.


SHITËSI

Rudolf DALIPI




BLERËSIT

Torpe MAZNIKU



Manuela HOXHA



Ilirjan HOXHA



NOTERI

Julian Zhelegu





VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
“TOLIMO” Sh.P.K.

Sot, me date 22.07. 2019, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te shoqerise “TOLIMO” Sh.P.K. (ne vijim “Shoqeria”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi J81623004A, me kapital themeltar 78.000.000 leke, me seli ne Njesia Bashkiake nr. 8, Rruga Zenel Bastari, ndertesa nr.33, hyrja nr.1, Magazina.1, kodi postar.101, pasi shqyrtoi pikat e meposhtme te rendit te dites:

1. Miratimi i shitjes se 30% te kapitalit te Shoqerise te zoteruara nga Ortaku Rudolf Dalipi ;
2. Te tjera eventuale;

Ne perputhje me dispozitat e Statutit te shoqerise dhe Ligjin 9901/2008, te ndryshuar, Asambleja e Ortakeve, unanimisht vendosi:

VENDOSI:

1. Te miratoje propozimet per transferimin e:
 - 10% te kapitalit te Shoqerise nga ortaku Rudolf Dalipi te Manuela Hoxha; dhe
 - 10% te kapitalit te Shoqerise nga ortaku Rudolf Dalipi te Ilirjan Hoxha; dhe
 - 10% te kapitalit te Shoqerise nga ortaku Rudolf Dalipi te Torpe Mazniku;Kontrata / marreveshja perkatese mund te konkludohet ndermjet paleve pa kufizim me miratimin e ketij vendimi.
2. Ky Vendim depozitohet per regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Duke mos pasur çeshtje te tjera per te diskutuar e vendosur, mbledhja e Asamblese u mbyll.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE



Rudolf Dalipi

[Signature]

Torpe Mazniku

Manuela Hoxha